

Komuna e Kamenicës
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë
Qendra Komunale e Biznesit - Kamenicë



PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE

Regjistrimi I bizneseve mund te realizohet në dy forma:

Forma fizike

Forma online

- ▶ Aplikimi mund të bëhet në çdo qendër komunale të ARBK-së, varësisht nga selia apo vendi i ushtrimit të veprimtarisë së subjektit që kërkon regjistrimin
- ▶ Për regjistrim të biznesit mund të aplikoni **Online** në: <https://rbk.rks-gov.net>

Çfarë duhet për regjistrimin fillestar?

► I. Formulari i aplikimit,

Për të filluar një regjistrim, një aplikanti duhet të plotësojë formularin e aplikimit. Përpara se të plotësohet formulari aplikimit, aplikanti duhet të dijë informacionin e mëposhtëm:

1. Formulari aplikimit është specifik për lloje të ndryshme shoqërisht tregtare që aplikojnë (persona fizikë që bëjnë biznes apo korporatë). Prandaj, aplikanti duhet të sigurohet që ai/ajo e di, nëse aplikimi do të jetë për një person fizik, i cili do regjistrohet për të kryer biznes apo për një korporatë si dhe llojin e korporatës. Informacioni mbi kërkesat ligjore të shoqërive tregtare mund të gjendet në ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare. Ky ligj mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e internetit të ARBK-së.

Çfarë duhet për regjistrimin fillestar?

2. Formularët e aplikimit mund të merren në dy mënyra:

a) pranë çdo qendre të ARBK-së; ose

b) mund të shkarkohen nga kjo faqe zyrtare e internetit të ARBK-së.

3. Të gjitha instruksionet për plotësimin e tyre mund të gjenden në çdo qendër të ARBK-së. Çdo zyrtar pranimi është gatshëm të ndihmojë aplikantin të plotësojë të gjitha rubrikat e detyrueshme të formularit të aplikimit.

Dorëzimi aplikimit për regjistrim në ARBK

1. Pasi formulari aplikimit plotësohet, aplikanti (ose personi i autorizuar për regjistrim) paraqet formularin e aplikimit personalisht, në çdo qendër shërbimi të ARBK-së, së bashku me dokumente të tjera shoqëruese, të duhura.
2. Aplikanti ose personi i autorizuar, identifikohet tek zyrtari ARBK-së nëpërmjet një dokumenti origjinal identifikimi, si dhe (për personin e autorizuar) nëpërmjet një autorizimi të nënshkruar, për përfaqësimin e aplikantit për qëllim regjistrimi.
3. Zyrtari i pranimit verifikon që aplikimi dhe dokumentet shoqëruese janë të plota dhe të pranueshme nga ARBK. Nëse aplikimi është i paplotë ose i pasaktë, zyrtari i pranimit do të njoftojë dhe ndihmojë për sqarimin dhe plotësimin e formularit.
4. Kur pranohet një formular aplikimi plotësuar, duhet të jetë i nënshkruar nga aplikuesi apo përfaqësuesi i autorizuar.
5. Taksa me rastin e regjistrimit të biznesit fillestar nuk paguhet, ndërsa për ndryshimet në biznesin ekzistues paguhet në bazë të Udhëzimit Administrativ të paraparë dhe të publikuar në faqen zyrtare të internetit të ARBK-së.

Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Biznesit Individual (B.I.) ose Ortakëri e Përgjithsme (O.P.):

1. Plotësimi formularit B,
 2. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë),
 3. Pëlqimin e Përfaqësuesit të regjistruar në bazë të nenit 24.5 pika d) e Ligjit Nr. 06/L-016,
 4. Për Ortakëri të Përgjithshme marrëveshjen e ortakëve të përgjithshëm në bazë të nenit 31.1.3 të Ligjit Nr. 06/L-016.
- Afati për kryerjen e regjistrimit të Biznesit Individual dhe Ortakërisë së Përgjithshme në ARBK është 2 ditë.

Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Ortakërisë së Kufizuar (O.K.)

1. Plotësimi i formularit A0,
2. Marrëveshja e shoqërisë në bazë të Nenit 32.13 të Ligjit Nr. 06/L-016,
3. Statuti,
4. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të pronarëve, përfaqësueseve të autorizuar të përfshirë në biznes,
5. Pëlqimin e Përfaqësuesit të regjistruar në bazë të nenit 24.5 të Ligjit Nr. 06/L-016,

Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K):

1. Plotësimi i formularit A0,
 2. Marrëveshja e shoqërisë në bazë të Nenit 82.1 të Ligjit Nr. 06/L-016,
 3. Statuti në bazë të nenit 33 të Ligjit Nr. 06/L-016,
 4. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të pronarëve, përfaqësueseve të autorizuar të përfshirë në biznes,
 5. Pëlqimin e përfaqësuesit të regjistruar në bazë të nenit 24.5 të Ligjit Nr. 06/L-016.
- ▶ Afati për kryerjen e regjistrimit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërive aksionare në ARBK është 3 ditë.

Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Shoqërive Aksionare (SH.A):

1. Plotësimi i formularit A0,
2. Statuti në bazë të Nenit 34.1.3 të Ligjit Nr. 06/L-016,
3. Marrëveshjen apo Rregulloren e Shoqërisë sipas Nenit 34.4 të Ligjit Nr. 06/L-016,
4. Pëlqimin e përfaqësuesit të regjistruar në bazë të nenit 24.5 te Ligjit Nr. 06/L-016,
5. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të pronarëve, përfaqësueseve të autorizuar të përfshirë në biznes.

Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Kompanisë së Huaj-Dega në Kosovë:

1. Plotësimi formularit A0,
 2. Vendimi për hapjen e Kompanisë së huaj,
 3. Vendimin për emërimin e Drejtorit (pasaporta kopje) dhe Përfaqësuesit të regjistruar (letërnjoftimi kopje),
 4. certifikatë apo ekstrakt regjistrimi (origjinal apo kopje e notorizuar, jo me e vjetër se tre muaj nga data e lëshimit dhe nëse nuk është në gjuhën shqipe, serbe apo angleze të përkthehet në njëën nga këto tri gjuhë dhe përkthimi të jetë i noterizuar) që e hap përfaqësinë në Kosovë,
 5. Kopje e pasaportit të pronarit dhe drejtorit të Kompanisë së huaj,
 6. Pëlqimin e Përfaqësuesit të Regjistruar në bazë të nenit 24.5 të Të Ligjit Nr. 06/L-016.
- Vërejtje: Nëse pronari i biznesit nuk është prezent kur dorëzohen dokumentet atëherë aplikuesi mund ti dorëzoj dokumentet me autorizim dhe letërnjoftim kopje.

Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Kooperativës Bujqësore:

1. Plotësimi i formularit K0,
2. Marrëveshja e Shoqërisë,
3. Statuti,
4. Vendimi për emërimin e drejtorit,
5. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të anëtarëve, personave të autorizuar të përfshirë në biznes,
6. Pëlqimin e Përfaqësuesit të regjistruar në bazë të nenit 24.5 të Ligjit Nr. 06/L-016.

Taksat për shërbimet e ofruara nga ARBK

Taksat për shërbimet e ofruara nga ARBK janë të përcaktuara në bazë të udhëzimit administrativ

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) Nr. 12/ 2022 PËR CAKTIMIN E TAKSAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE

Për Bizneset individuale dhe Ortakëritë e Përgjithshme duhet të paguhen këto taksa:

- ▶ Regjistrimi fillestar i biznesit.....0.00 €
- ▶ Kërkesa për Shuarje te biznesit e shuarje njësisë..... 0.00 €
- ▶ Ndryshimi i Adresës dhe Emrit Tregtar, adresës së banimit te pronarët apo Përfaqësuesve te Autorizuar dhe Numrit te telefonit te biznesit dhe emailit.....2,50 €
- ▶ Ndryshimet te personat e autorizuar (Përfaqësuesi i Autorizuar apo Drejtor) 2,50 €
- ▶ Regjistrimi dhe çdo ndryshim te Njësitë e Veprimtaritë.....2,50 €
- ▶ Ndërrim i formës së biznesit nga B.I. në O.P. apo e kundërta.....2,50 €
- ▶ Ndërrim i numrit të punëtorëve,..... 0.00 €
- ▶ Marrja e Çerifikatës duplikatë apo me datë të re.....2.00 €
- ▶ Kërkesa për marrjen e vërtetimit duplikat për shuarje..... 0.00 €
- ▶ Vërtetim lidhur me biznesin, pronar apo drejtor dhe vërtetim që nuk ka biznes..... 1.00 €
- ▶ Vërtetimi (vulosja) e çdo kopjes autentike për faqe..... 0,50 €
- ▶ Informatat, Historia e biznesit apo marrja e fotokopjes se dokumentit të biznesit për faqe.....0.20 €
- ▶ Lëshimi i informatave në formë elektronike për 10KB(kilobajt) për faqe.....0.50 €

Për Shoqëritë Aksionare, Shoqëritë me Përgjegjësit te Kufizuar, Ortakërit e Kufizuar, Dega e Shoqërisë së Huaj Tregtare dhe Kooperativat Bujqësore:

▶ Harmonizimi ose rifreskimi komplet i statutit ose memorandumit.....	5.00 €
▶ Regjistrim fillestar i biznesit.....	0.00 €
▶ Kërkesa për Shuarje te biznesit e shuarje njësisë.....	0.00 €
▶ Regjistrimi dhe çdo ndryshim te Njësitë	5.00 €
▶ Ndryshimi dhe Bartja e Emrit Zyrtar e Tregtar te biznesit	5.00 €
▶ Ndryshimet te personat e autorizuar (Përf.aut., drejtori dhe B. Drejtorëve).....	5.00 €
▶ Ndryshimi i Adresës dhe Emrit të Biznesit. Adresës së banimit të pronarët apo Përfaqësuesëve të Autorizuar dhe Numrit te telefonit te biznesit dhe emali.....	5.00 €
▶ Ndërrim Pronarëve dhe ndryshim në Kapital dhe vlerës të aksioneve.....	5.00 €
▶ Ndryshimin e Veprimtarive të biznesit	5.00 €
▶ Ndërrim i Tipit te biznesit, bashkimi ose ndarjes së Shoqërive Tregtare	5.00 €
▶ Ndërrim i numrit të punëtorëve	0.00 €
▶ Marrja e Çerifikatës duplikatë apo me datë të re.....	2.00 €
▶ Kërkesa për marrjen e vërtetimit duplikat për shuarje.....	0.00 €
▶ Vërtetim lidhur me biznesin, pronar apo drejtor dhe vërtetim që nuk ka biznes.....	1.00 €
▶ Vërtetimi (vulosja) e çdo kopjes autentike për faqe.....	0.50 €
▶ Informatat, Historia e biznesit apo marrja e fotokopjes se dokumenteve të biznesit për faqe.....	0.20 €
▶ Lëshimi i informatave në formë elektronike për 10KB(kilobajt)- për faqe.....	0.50 €